

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT TË KOMISIONERIT
PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI (KMD) PËR VITIN 2016

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke respektuar të drejtat themelore kushtetuese si të pacenueshme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme, në mbrojtje të së drejtës për barazi para ligjit, për shanse dhe mundësi të barabarta, si dhe në zbatim me efektivitet të politikave për mbrojtjen nga diskriminimi dhe parandalimin e tij, si përparësi për procesin e integritetit evropian të vendit;

- Në përmbushje të angazhimeve për garantimin e një shoqërie tolerante, demokratike dhe të drejtë, si parakusht për respektimin e çdo pakice, pjesë e shoqërisë shqiptare;

- Duke vlerësuar rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion i pavarur që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin;

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se gjatë vitit 2016:

- Sipas raportit të Komisionerit gjatë vitit 2016 grupet më të cenuara nga shkeljet diskriminuese janë komuniteti rom dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara, komuniteti LGTBI dhe gratë.

- Numri i ankesave të regjistruara dhe të trajtuara nga KMD-ja në vitin 2016 është më i ulët, krahasuar me vitin 2015, edhe pse në rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015”, kërkohej rritja e identifikimit të rasteve ku pretendohet diskriminim. Edhe në Progresraportin e BE-së për Shqipërinë të vitit 2016 konstatohet se “KMD-ja ka trajtuar një numër më të ulët të rasteve”.

- Ka një rënie të lehtë të numrit të çështjeve të nisura kryesisht gjatë vitit 2016, krahasuar me vitin paraardhës. Në rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015” kërkohej rritja e hetimeve të nisura kryesisht.

- Është rritur pjesëmarrja e KMD-së në proceset gjyqësore, krahasuar me vitin 2015, duke përmbushur rekomandimin e rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015”, ku kërkohej konsolidimi i mëtejshëm i rolit të KMD-së, lidhur me rastet e paraqitura në sistemin gjyqësor. Në Progresraportin e BE-së për Shqipërinë konstatohet se “KMD-ja të shtojë përpjekjet për të ndërtuar një jurisprudencë antidiskriminim që të jetë e qëndrueshme”.

- KMD-ja ka vijuar ndërgjegjësimin dhe informimin publik, nëpërmjet shpërndarjes së materialeve ndërgjegjëse, broshurave informative mbi ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi, botimeve, me vijimin e organizimit të ditëve të hapura me komunitetin, 19 sesioneve të trajnimit me punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Ka organizuar konferencën “Zbatimi i ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi” me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm, me përfaqësues nga institucionet qendrore dhe vendore, OJF-ve etj.

- Numri i ankesave për diskriminim, të paraqitura pranë KMD-së, për shkak të gjinisë, aftësisë së kufizuar dhe orientimit seksual e identitetit gjinor vijon të mbetet i ulët, në raport me sjelljet diskriminuese që këto grupe të cenuara përballen, referuar të dhënave të raportit vjetor. Në rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015” kërkohej forcimi i bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, veçanërisht organizatat që mbrojnë të drejtat e grupeve të dobëta, me qëllim identifikimin dhe shqyrtimin e rasteve të diskriminimit gjinor, racës, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual ose identitetit gjinor, të referuara prej tyre.

- Shkaku për të cilin pretendohen më së shumti sjellje diskriminuese dhe që përbën edhe numrin më të madh të ankesave për këtë shkak, është raca. Krahasuar me vitin 2016 ka një rritje të ankesave ku pretendohet diskriminim për shkak të gjendjes ekonomike, bindjeve politike dhe aftësisë së kufizuar.

- Numri i vendimeve që konstatojnë diskriminim mbetet i ulët, në raport me numrin total të vendimeve të dhëna, si dhe me numrin total të ankesave të paraqitura për shqyrtim, të cilat pretendojnë diskriminim. Në Progresraportin e BE-së për Shqipërinë, të vitit 2016, konstatohet se “Nevojiten më shumë përpjekje, për të zhvilluar historikun e rasteve kundër diskriminimit”.

- KMD-ja ka kontribuar në përmirësimin e legjislacionit, në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, duke i propozuar 5 rekomandime legjislative autoriteteve përgjegjëse. KMD-ja ka përmbushur pikën 2 të pjesës rekomanduese të rezolutës së Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015”.

- KMD-ja ka vendosur një numër më të ulët të masave administrative me gjobë, për moszbatim të

vendimeve të tij, apo mosdhënie të informacionit nga ana e subjekteve, në raport me vitin paraardhës.

- KMD-ja ka kontribuar në hartimin e raporteve/raportimeve në kuadrin e organizmave ndërkombëtarë dhe rajonalë, si dhe procesin e integritetit europian. Ka përgatitur një studim krahasimor mes legjislacionit shqiptar dhe atij europian “Mbi kriteret e pranimi të punonjësve të policisë”, i cili është në fazën përfundimtare të hartimit.

- Në kuadër të projektit të përbashkët të BE-KE-së, “Rritja e efektivitetit të sistemit shqiptar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit”, KMD-ja ka zhvilluar takime institucionale, me ekspertë të KE-së, me qëllim hartimin e rekomandimeve prej tyre, ndër të tjera, lidhur me vlerësimin e Planit Strategjik 2012-2015 të KMD-së, ndryshimin dhe përmirësimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe kuadrit ligjor që lidhet me zbatimin e tij. KMD-ja ende nuk ka propozuar rekomandimet konkrete mbi përmirësimin e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

- KMD-ja nuk ka paraqitur në raportin vjetor gjetjet dhe rezultatet e monitorimeve të zbatimit të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” në fushën e punësimit, në sektorin privat dhe në gjykata, edhe pse në rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2015” kërkohej paraqitja e tyre.

Kuvendi kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2017:

- Të vijojë përpjekjet për konsolidimin e mëtejshëm të rolit të tij, lidhur me rastet e paraqitura në sistemin gjyqësor, për zgjerimin e grupeve përfituese, në përmbushje të qëllimit dhe objektit ligjor, duke pasur në vëmendje reformën në sistemin e drejtësisë dhe rekomandimet konkrete në lidhje me procesin e integritetit europian të Shqipërisë.

- Të realizojë hartimin e strategjisë së veprimtarisë së institucionit (2017-2021), si dhe planin e tij të veprimit.

- Përpjekje më të thelluara në zbatimin efektiv të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të respektojë dhe të reflektojë dinamikën, në përputhje me ndryshimet kushtetuese, nëpërmjet zgjerimit të grupeve të asistuar, rritjes së numrit të rekomandimeve drejtuar autoriteteve përgjegjëse dhe konsolidimit të praktikës ligjore të institucionit.

- Të propozojë ndryshime dhe përmirësime ligjore, të kuadrit rregullator në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, që rrjedhin prej punës kërkimore dhe analizave studimore të rasteve të shqyrtuara nga KMD-ja, në përmbushje të cilësisë dhe profesionalizmit, si dhe në ndihmë të jurisprudencës në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

- Të monitorojë efektivitetin e ndryshimeve dhe përmirësimeve që ka pësuar kuadri ligjor gjatë vitit 2016 në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit, të drejtave dhe lirive themelore, gjithëpërfshirjes dhe kohezionit social, dhe efektivitetin e tyre nga institucionet shtetërore.

- Të realizojë monitorimin e aksesueshmërisë së personave me aftësi të kufizuara në fushën e të mirave dhe shërbimeve, arsimit dhe punësimit.

- Të konsolidojë mekanizmat ligjorë, për të forcuar bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile, që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, me theks të veçantë mbrojtjen e të drejtave të grupeve të dobëta, bazuar në një plan veprimi të mirëpërcaktuar.

- Ndërmarrjen në vazhdimësi të fushatave ndërgjegjësuere për publikun dhe grupet e interesit, me qëllim rritjen e identifikimit dhe trajtimit të rasteve me objekt diskriminimi, si dhe në funksion të rritjes së çështjeve të nisura kryesisht.

- Të sigurohet roli më aktiv i KMD-së në mediat vizive dhe të shkruara, veçanërisht nga Televizioni Publik Shqiptar, si dhe televizionet me licencë kombëtare, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit publik lidhur me të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi.

- Të garantojë transparencën institucionale përmes përditësimit të faqes zyrtare të institucionit, me të gjitha aktivitetet institucionale, si dhe publikimin në vazhdimësi të të gjitha akteve, vendimeve, rekomandimeve, raporteve etj.

Miraturar në datën 4.5.2017

KRYETARI
Ilir Meta